

Ngritja e Kapaciteteve dhe Rritja e Shkallës së Informimit dhe Ndërgjegjësimit Publik për Nxitjen e Migracionit të Rregullt në Ballkanin Perëndimor

Buletin Informativ Nr. 2 – dhjetor 2008



Shërbimet e "Sporteleve të Migracionit" promovuar në Panairin e Punës në Tiranë

Nga data 23-24 tetor 2008, Misioni IOM në Tiranë mori pjesë në Panairin e Punës organizuar në Pallatin e Kongreseve nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Drejtorja Rajonale e Punësimit të Tiranës nën kujdesin e Kryeministrit të Shqipërisë, SH.T.Z. Sali Berisha. IOM, si një nga partneret e Drejtorisë Rajonale të Punësimit të Tiranës në nxitjen e migracionit të rregullt nëpërmjet "Sporteleve të Migracionit" të ngritura rishtas për të ofruar shërbimin e informimit, këshillimit dhe referimit mori pjesë në Panairin e Punës "Tirana 2008" për të promovuar shërbimet e Sporteleve të Migracionit. Aktivitetet e IOM në Shqipëri u prezantuan në një standë ku ndërmjet të tjerave u ekspozuan materiale promocionale dhe informuese mbi shërbimet e reja të ofruara nga Rrjeti Kombëtar i Sporteleve të Migracionit i ngritur brenda strukturave të Drejtorive Rajonale të

Punësimit në 14 zona të Shqipërisë. Një Spot Televiziv nëpërmjet të cilit informohen njerëzit e interesuar rreth mundësive për të migruar jashtë vendit për qëllime punësimi apo studimi se ku të drejtohen për të kërkuar informacion dhe këshillim mbi migracionin e rregullt, u prezantua në këtë aktivitet. IOM gjithashtu ftoi një grup studentësh nga Universiteti i Tiranës për të vizituar standën dhe për t'u informuar rreth shërbimeve të ofruara. Studentët u njohën me mundësitë e reja të studimeve jashtë vendit si p.sh. bursat universitare dhe pas universitare të cilat bëhen të mundura nëpërmjet programit ERASMUS MUNDUS financiar nga BE; bursat e ofruara nga Instituti për Shoqërinë e Hapur dhe programi DAAD. Studentët u informuan nga OJF-ja italiane, ACLI/IPSIA, në lidhje me procedurat e aplikimit për të studiuar në Itali. Informacion u ofrua dhe në lidhje me listën e 27 profesioneve më të kërkuara për leje pune në Mbretërinë e Bashkuar.

Përrurimi i Qendrës së Shërbimit për Migrantët në Beograd në Ditën Ndërkombëtare të Migrantëve (18 dhjetor 2008)



Në Konferencën për shtyp mbajtur në datë 18 dhjetor 2008 në Beograd përfaqësuesit e Misionit të IOM në Serbi, Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP) dhe Komisionit European bënë përrurimin zyrtar të projektit në Ditën Ndërkombëtare të Migrantëve. Siç theksoi dhe Zj. Danica Vasiljevic, Zv Drejtore e SHKP në Republikën e Serbisë, pjesa më e rëndësishme e projektit është forcimi i kapaciteteve të institucioneve lokale

për të zhvilluar politika dhe praktika të mira ligjore në kontekstin e nevojave për fuqi të huaj punëtore dhe migracion të mundshëm në rajon. Rezultatet e projektit gjatë periudhës qershor-dhjetor 2008 u prezantuan nga Zj. Milena Milivojev, Koordinator e projektit. Zj. Milivojev informoi se më shumë se 300 klientë ishin asistuar nga Qendra e Shërbimit për Migrantët në Beograd. Sipas të dhënave të Qendrës më shumë se 200 vizitorë ishin meshkuj. 2/3 e tyre ishin me arsim të mesëm dhe 1/3 e tyre ishin me arsim të lartë. Rezultatet e studimit dhe mbledhja e të dhënave për migrantët potencialë do të prezantohen në raportin përfundimtar i planifikuar në vitin 2010 me shpresën për të ofruar një pamje të qartë të profilit të migrantëve potencialë nga Ballkani Perëndimor.

Panairi i Punës në Sarajevë

Në 17 dhjetor 2008, Misioni IOM në Sarajevë mori pjesë në panairin e dytë të organizuar nga Shërbimi i Punësimit të Sarajevës.

Sipas Shërbimit Federal të Punësimit, rreth 40 kompani të ndryshme morën pjesë si dhe mijëra punëkërkuar vizituan panairin. Fjala e hapjes në këtë panair u mbajt nga Zj. Miralem Saric, Drejtore e Shërbimit Federal të Punësimit, Z. Huso Saric, Drejtor i Agjencisë së Punës dhe Punësimit të Bosnjës dhe Hercegovinës Zj. Emina Dubravac Nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale, Refugjatëve dhe Personave të Shpërngulur të Sarajevës; si dhe nga Z. Vahid Muharemovic, Drejtor i Shërbimit të Punësimit të Sarajevës.




Misioni IOM në Sarajevë, së bashku me Shërbimin Federal të Punësimit mori pjesë në këtë panair për të promovuar migracionin e rregullt nëpërmjet ofrimit të shërbimit të informimit, këshillimit dhe referimit në kuadër të ngritjes rishtas të Qendrës së Shërbimit për Migrantët. Misioni IOM në Sarajevë së bashku me Shërbimin Federal të Punësimit prezantuan në stendën e përbashkët materialet promocionale të Qendrës dhe ofruan informacion. Shumë punëkërkuar shfaqën interes në marrjen e informacionit rreth ofertave të disponueshme të punës jashtë vendit. Shumë vizitorë kërkonin informacion rreth mundësive për punësim në shtete të ndryshme dhe rreth shkallës së vështirësisë për të gjetur punë për profesionet që kishin. Studentët kërkonin informacion rreth procesit të njehsimit të diplomës dhe gjetjes së punës duke pasur eksperiencë të kufizuar pune.

Përzgjedhje statistikash lidhur me përdoruesit e Qendrave të Shërbimit për Migrantët/Sportelevë të Migracionit (shtator – nëntor 2008)

Numri total i klientëve që kanë vizituar Qendrat e Shërbimit për Migrantët/Sportelet e Migracionit gjatë tremestrit të dytë të veprimtarisë së tyre (shtator-nëntor 2008) ishte 1042 me një total vizitorësh prej 1070. Pjesa më e madhe e klientëve ishin vendas, dhe një përqindje e vogël ishin imigrantë në këto vende (7.1%).

Numri më i madh i vizitorëve është regjistruar në Serbi, Kosovë, Shqipëri dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. 72% e klientëve janë meshkuj kryesisht në moshën 30-35 vjeç. Pjesa më e madhe e klientëve vijnë nga zonat urbane (87%).


Të papunët përbënin një pjesë të madhe të klientëve të Qendrave të Shërbimit për Migrantët/Sportelevë të Migracionit (59%). Është paraqitur gjithashtu një shifër e lartë e sektorëve të punësimit.



36% e vizitorëve kanë emigruar më parë. Kjo përqindje është më e vogël se periudha raportuese pararendëse (qershor-gusht 2008) ku më shumë se gjysma e klientëve kishin emigruar më parë. Pjesa më e madhe e klientëve që kishin emigruar më parë kishin aplikuar për azil ose për punë.

Gjermania, Greqia, dhe Zvicra ishin ndër vendet më të kërkuara. Pjesa më e madhe e klientëve janë të interesuar për migracionin me qëllim punësimin në Kanada, BE në përgjithësi, Itali, Gjermani dhe SHBA.

Asistenca e ofruar nga Qendrat e Shërbimit për Migrantët/ Sportelet e Migracionit është kryesisht dhënia e informacionit (95%) e ndjekur nga këshillimi dhe referimi që zënë respektivisht 3% dhe 2% të shërbimit të ofruar.



Për një raport më të zgjeruar referohuni tek <http://www.migrantservicecentres.org>

Mbledhja e Komitetit Drejtues të Projektit – shtator 2008 Sarajevë



Mbledhja e Komitetit Drejtues të Projektit u mbajt në shtator 2008 në Sarajevë. Në këtë mbledhje morën pjesë koordinatorët e Projektit nga të gjithë vendet e rajonit, përfaqësues të Misionit IOM në Budapest, përfaqësues nga zyrat kryesore të IOM në Gjenevë, Misionit të IOM në Bruksel, ILO, Ambasada e Zvicrës në Kosovë, Zyra e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Sarajevë dhe Delegacioni i Komisionit European në Bosnjë dhe Hercegovinë. Kordinatorët e projektit prezantuan veprimtarinë e Qendrave të Shërbimit për Migrantët/ Sporteleve të Migracionit në vendet e tyre si dhe diskutuan mbi aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve kombëtare dhe rajonale duke përfshirë seminarin rajonal në Tiranë.

Mbledhja e Komitetit Drejtues Pjesëmarrësit, nga e majta: Anne Pawletta (ILO), Regina Boucault (IOM Sarajevë), Monika Lazar (IOM Budapest), Sanja Celebic-Lukovac (IOM Bruksel)



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Federal Office
for Migration
and Refugees



GOVERNMENT
OF LIECHTENSTEIN